



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
SKUPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 të Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës Nr. 2003/22 si dhe nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110/78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KUSHTEVE SANITARO –
TEKNIKE

I. Komisioni themelohet në përbërje prej:

1. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastrukturë , kryesues;
2. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
3. Shehide Sopa, Ibrahim, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
4. Burim Kodra, Drejtorati për Inspektorat, anëtar rezervë

II. Detyrat themelore dhe përgjegjësitë e Komisionit

Në procedurën e dhënies së lejeve ndërtimore për ndërtimin e objekteve ndërtimore, Komisioni i themeluar shqyrton dokumentacionin teknik dhe jep pëlqimin për harmonizimin e projektit kryesor me kushtet sanitaro – teknike të ndërtimit.

Dokumentacioni për pëlqimet sanitaro – teknike bëhet për projektet kryesore të objekteve të kategorisë së II-të.

Komisioni i themeluar, bënë shqyrtimin e dokumentacionit për dhënien e pëlqimit brenda tetë (8) ditësh pas pranimit të dokumentacionit për shqyrtim. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, e dorëzon me kohë dokumentacionin teknik te Komisioni, duke pasur parasysh që Komisioni të kryej detyrat e caktuara brenda afatit ligjor për dhënien e përgjigjes për leje ndërtimore.

Në rastet kur dokumentacioni i shqyrtuar ka nevojë të plotësohet apo ndryshohet, atëherë Komisioni përmes Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kërkon nga parashtruesi i lëndës që brenda pesë (5) ditësh të bëjë përmirësimet e caktuara.

Në rastet se ndonjëri nga anëtarët në numrat rendor 1,2,3 ka konflikt interesi për ndonjë lëndë të caktuar do të zëvendësohet nga anëtari rezervë në numrin rendor 4.

III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe do të zbatohet deri në një Vendim tjetër.

Arsyetim

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës, është përcaktuar marrja e pëlqimit sanitar para dhënies së lejes ndërtimore. Meqenëse nga fillimi i vitit 2022 inspektorët sanitar komunal kanë kaluar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, vendet e inspektorëve sanitar komunal kanë mbetur të pa mbuluara dhe si rrjedhojë e kësaj çështjet për pëlqime sanitare lidhur me projektin kryesor nuk mund të shqyrtohen.

Për sqarimin e kësaj çështjeje, me datën 25.03.2022 i kemi drejtuar një shkresë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe të njejten ditë kemi pranuar përgjigjen nga Agjencia se nga ana e tyre nuk mund të ofrohet ndonjë zgjidhje.

Prandaj, të ndodhur në këtë situatë të krijuar, si dhe duke pasur parasysh detyrimet e përcaktuara me nenin 17 dhe 21 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtimin, u vendos të themelohet Komisioni për shqyrtimin e kushteve sanitaro – teknike të projekteve kryesore, ashtu edhe siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen:

Të emëruarit në Komisionin e caktuar;
DPUMM

01 Nr. 020/04-18098
Lipjan, më 06.04.2022

